

VIG Service Sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2013**

(Shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur)



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
VIG Service Sh.p.k

Tiranë, 7 prill 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të VIG Service Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga bilanci kontabel në 31 dhjetor 2013, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabel dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.


Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabel të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabel të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Steven Nutley
Partner



KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

VIG Service Sh.p.k.**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

AKTIVET	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Aktivitet afatshkurtra:			
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	4	3,188,521	3,900,014
Kërkesa të arkëtueshme	5	11,349,985	5,649,699
Aktivitet afatgjata:			
Paisje	6	7,083,648	8,707,771
Aktive afatgjata jo-materiale	7	67,023	95,125
Tatim i parapaguar i fitimit		301,294	-
Totali i aktiveve		21,990,471	18,352,609
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet:			
Detyrime ndaj aksionarëve	8	-	710,048
Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	4,840,636	1,161,010
Të pagueshme të tjera	10	3,375,085	5,105,610
Detyrime për tatime		-	455,594
Totali i detyrimeve		8,215,721	7,432,262
Kapitali:			
Kapitali aksionar	11	8,760,000	8,760,000
Fitimet e pashpërndara		5,014,750	2,160,347
Totali i kapitalit		13,774,750	10,920,347
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		21,990,471	18,352,609

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

VIG Service Sh.p.k.**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<i>Shënime</i>	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Të ardhurat	12	80,650,542	48,209,635
Shpenzimet e personelit	13	(57,685,805)	(36,038,204)
Shpenzime administrative	14	(17,645,664)	(8,347,415)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	6,7	<u>(2,090,532)</u>	<u>(1,180,610)</u>
Fitim nga veprimtaria kryesore		<u>3,228,541</u>	<u>2,643,406</u>
Kosto financiare neto			
Të ardhura financiare	15	1,639	9,163
Shpenzime financiare	15	<u>(48,287)</u>	<u>(36,565)</u>
Shpenzime financiare neto		<u>(46,648)</u>	<u>(27,402)</u>
Fitimi para tatimit		3,181,893	2,616,004
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	16	<u>(327,490)</u>	<u>(455,594)</u>
Fitimi për vitin		<u>2,854,403</u>	<u>2,160,410</u>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

VIG Services Sh.p.k.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimi i pashpërndarë/(deficiti)	Totali
Gjendja më 1 janar 2012	4,200,000	(63)	4,199,937
Fitimi neto per periudhën	-	2,160,410	2,160,410
Rritja e kapitalit aksionar	4,560,000	-	4,560,000
Gjendja më 1 janar 2013	8,760,000	2,160,347	10,920,347
Fitimi neto për vitin	-	2,854,403	2,854,403
Gjendja më 31 dhjetor 2013	8,760,000	5,014,750	13,774,750

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

VIG Services Sh.p.k.**Pasqyra e fluksit monetar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)*

	<i>Shënime</i>	2013	2012
Flukset monetare nga aktivitetet operacionale			
Fitimi pas tatimit		2,854,403	2,160,410
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	6,7	2,090,532	1,180,610
Shpenzime financiare	15	48,287	36,565
Të ardhura financiare	15	(1,639)	(9,163)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operacionale:</i>			
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	5	(5,700,286)	(5,649,699)
Rritja në llogaritë e pagueshme	9	3,679,626	1,161,010
Rritja e detyrimeve të tjera	10	(1,730,525)	5,105,610
Ndryshimi në tatimin mbi fitimin		(756,888)	455,594
Interes i arkëtuar	15	1,639	9,163
Interesa dhe komisione të paguara	15	(48,287)	(36,565)
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operacionale		436,862	4,413,535
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(438,307)	(9,871,099)
Blerje e aktiveve jo-materiale	7	-	(112,407)
Mjete monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(438,307)	(9,983,506)
Aktivitetet financiare			
Pagesat për rritje kapitali nga aksionarët (Daljet)/Hyrje nga huamarrjet		-	4,560,000
		(710,048)	710,048
Mjete monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financiare		(710,048)	5,270,048
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to			
		(711,493)	(299,923)
Mjete monetare dhe ekuivalentë në 1 janar	4	3,900,014	4,199,937
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor	4	3,188,521	3,900,014


Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Drejtimi i VIG Service Sh.p.k. më 7 Prill 2014 dhe janë firmosur nga:

Ilir Elmazi
Administrator



Sahit Basha
Accountant



VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

1. Njësia raportuese

VIG Service Sh.p.k. (“Shoqëria”) u themelua në Shqipëri më 22 dhjetor 2011 në Tiranë, Shqipëri, me qëllim për të vepruar si një qendër shërbimesh e përbashkët për ofrimin e shërbimeve manaxheriale entiteteve të Vienna Insurance Group (“VIG”) që operojnë në Shqipëri.

Adresa e selisë kryesore të biznesit është Rr. “Abdyl Frashëri”, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria Mëmë me e fundit është Vienna Insurance Group AG e vendosur në Vien, Austri.

Më 31 dhjetor 2103, Shoqëria ka pasur 35 punonjës (2012: 36) dhe aksionarët janë si më poshtë:

	Në %	
	2013	2012
Interalbanian Sha	33.33	33.33
Intersig Sha	33.33	33.33
Sigma Sha	33.33	33.33
Më 31 dhjetor	100.00	100.00

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 “Tatim Fitimi”, paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos raportojë në pasqyrat e saj financiare për tatimin e shtyrë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në LEK, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Vlerësimet dhe gjykimet

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimet dhe supozimet e tyre që ndikojnë në procesin e zbatimit të politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurive dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale.

3. Politikat Kontabël**(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitetet dhe detyrimet e jo-monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me vlerën e drejtë konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit të datës në të cilën u përcaktua vlera e drejtë. Aktivitetet dhe detyrimet e tjera jo-monetare në monedhë të huaj të cilat janë matur me kosto historike konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit të datës në të cilën ka ndodhur transaksioni. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(b) Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentat e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre maten me kosto të amortizuar në pasqyrën e gjendjes financiare

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme në hyrje njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjerë të pagueshëm

Llogaritë e pagueshme dhe të tjerë të pagueshëm, në hyrje njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar

Të tjera

Instrumenta të tjerë financiarë jo-derivativë janë matur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3.i.

Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë matet me vlerë nominale.

VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve afatgjata materiale vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka).

Zërat e aktiveve afatgjata materiale vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka).

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka), çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve gjatë ndërtimit mbarten në “Aktive fikse të parapaguara” dhe kapitalizohen e transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundohet, moment ky në të cilin fillon të aplikohet zhvlerësimi me normën përkatëse të kategorisë së ciles i përket aktiviteti.

Në rastet kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme.

Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si humbje apo fitime në periudhën që ato kryhen.

(iii) Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe llogaritet me metodën e vlerës së mbetur. Aktivet fikse të parapaguara nuk zhvlerësohen.

Normat e zhvlerësimit për periudhën korrente dhe ato krahasuese janë si më poshtë:

• Automjete	25%
• Pajse zyre dhe dhomash	20%
• Kompjuterat dhe Serverat	25%
• Të tjera	25%

Normat e zhvlerësimit dhe vlerat e mbetura të aktiveve afatgjata materiale, kur janë të rëndësishme, rivlerësohen në datën e raportimit.

(d) Aktivet jo-materiale

Aktivitetet jo-materiale të blera prej Shoqërisë njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka). Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruara në aktivitetin specifik të cilit i referohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në humbje dhe fitime në periudhën kur ndodhin. Amortizimi njihet në humbje ose fitime mbi bazën e vlerës së mbetur me një normë 25% në vit, duke filluar që prej datës në të cilën aktivitetet kanë qënë të gatshme për përdorim.

VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

(e) Zhvlerësimi

(i) Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën fillestare efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera të mbetura financiare, si për shembull të arkëtueshmet, vlerësohen kolektivisht, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivët jo-financiarë

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiarë të Shoqërisë, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivit apo shuma e parave që ai gjeneron tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(f) Shpenzimet për personelin

Kontribute për Sigurimet Shoqërore

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, sipas legjislacionit në fuqi, Shoqëria kryen pagesa për të kontribuar në pensionet e detyrueshme, si për llogari të saj ashtu edhe për llogari të punonjësve të saj. Kostot që i takojnë Shoqërisë paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën në të cilën ato ndodhin.

Lejet e zakonshme të paguara

Shoqëria njih si detyrim shumat e plota të kostove të vlerësuara lidhur me lejet vjetore që pritet ti paguhen punonjësve përkundrejt shërbimit të tyre për periudhën e plotë raportuese.

(g) Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim të tanishëm ligjor apo konstruktiv, detyrim i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe që për shlyerjen e tij mund të jetë e nevojshme dalja e burimeve ekonomike. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë përmes një norme para tatimit që reflekton vlerësimin korrent të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të lidhura me detyrimin në fjalë.

VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

(h) Njohja e të ardhurave

Nëse rezultati i një transaksioni që lidhet me ofrimin e një shërbimi mund të matet në mënyrë të besueshme, e ardhura e lidhur me këtë transaksion do të njihet në masën që i korrespondon fazës së perfundimit të transaksionit në datën e raportimit.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat prej fondeve të investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. E ardhura nga interesat njihet ndërsa fitohet.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave prej huave dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Të gjitha kostot e huamarrjes, nëse ka, do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(j) Shpenzimet për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin është tatimin e periudhës i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës përbën tatimin e pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore të miratuara për periudhën.

VIG Service Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***4. Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë**

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përbëhen nga:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
LEK	2,995,766	3,851,200
EUR	179,372	43,287
USD	13,383	5,527
Totali	3,188,521	3,900,014

5. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Intersig VIG Sh.a	6,276,041	3,155,535
Sigma VIG Sh.a	2,283,453	2,120,806
Interalbanian VIG Sh.a	2,784,623	367,490
Ciceroni	5,868	5,868
Totali	11,349,985	5,649,699

6. Aktivët afatgjatë materiale

Aktivët afatgjatë material përbëhen nga:

	Mjete transporti	Mobilje dhe paisje	Kompjuterë dhe Servera	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>					
Më 1 janar 2013	2,434,407	1,750,785	5,633,171	52,736	9,871,099
Shtesat	-	22,750	1,590,557	-	1,613,307
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(1,175,000)	-	(1,175,000)
Më 31 dhjetor 2013	2,434,407	1,773,535	6,048,728	52,736	10,309,406
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>					
Më 1 janar 2013	194,232	153,174	812,368	3,554	1,163,328
Shtesa	448,035	319,902	1,284,656	9,837	2,062,430
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2013	642,267	473,076	2,097,024	13,391	3,225,758
<i>Vlera kontabël neto</i>					
Gjëndja më 31 dhjetor 2012	2,240,175	1,597,611	4,820,803	49,182	8,707,771
Gjëndja më 31 dhjetor 2013	1,792,140	1,300,459	3,951,704	39,345	7,083,648

VIG Service Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***7. Aktivet jo-materiale**

Aktivet jo-materiale përbëhen nga:

	Program kompjuterik
Kosto	
Më 1 janar 2013	112,407
Shtesa	-
Nxjerrje jashte përdorimit	-
Më 31 dhjetor 2013	112,407
Amortizim i akumuluar	
Më 1 Janar 2013	17,282
Shtesa	28,102
Nxjerrje jashte përdorimit	-
Më 31 dhjetor 2013	45,384
Vlera kontabël neto	
Më 31 dhjetor 2012	95,125
Më 31 dhjetor 2013	67,023

8. Detyrime ndaj aksionarëve

Detyrimet ndaj përfaqësorëve shuma të detyrueshme ndaj Sigma VIG Sh.a. për sasi të kapitalit aksionar të kontribuara në tepriç të shumave të rena dakort midis aksionarëve.

9. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Vienna Insurance Group AG	3,132,284	684,844
Sigma VIG Sh.a	-	322,000
Intersig VIG Sh.a	154,166	154,166
Eagle Mobile Sh.a	60,092	-
KPMG Albania	210,135	-
Deloitte Albania	725,599	-
Rasim Disha	558,360	-
Total	4,840,636	1,161,010

10. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera përbëhen nga:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
TVSH e pagueshme	1,856,468	1,223,822
Detyrime ndaj personelit	134,879	2,492,619
Tatimi mbi të ardhurat personale	398,345	417,680
Sigurime shoqërore	767,310	748,950
Shpenzime të përllogaritura	181,065	201,129
Llogari të tjera të pagueshme	37,018	21,410
Totali	3,375,085	5,105,610

VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

11. Kapitali aksionar

Shoqëria ka lëshuar dhe autorizuar një kapital aksionar që përbëhet nga 100 aksione (2012: 100) me vlerë nominale të fiksuar në 87,600 LEK për aksion (2012: 87,600 LEK për aksion).

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 kapitali aksionar përbëhet nga:

	Në %		(Në LEK)	
	2013	2012	2013	2012
Interalbanian VIG Sha	33.33	33.33	2,920,000	2,920,000
Intersig VIG Sha	33.33	33.33	2,920,000	2,920,000
Sigma VIG Sha	33.33	33.33	2,920,000	2,920,000
Totali i kapitalit aksionar	100.00	100.00	8,760,000	8,760,000

12. Të ardhurat

Balanca përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Sigma VIG Sh.a	25,730,180	18,107,660
Interalbanian Sh.a	25,676,283	15,142,537
Intersig Sh.a	29,244,078	14,959,438
Total	80,650,542	48,209,635

Në përputhje me marrëveshjen e shërbimit të nënshkruar midis Shoqërisë (“Ofruesi i Shërbimit”) dhe aksionarëve të saj (“Përfituesit e Shërbimit”) do të ofrohen shërbimet e mëposhtme:

- Menaxhimi i dëmeve;
- Shërbime IT –je dhe
- Shërbime finance dhe kontabiliteti.

Për shërbimet e menaxhimit të dëmeve Ofruesi i Shërbimit do të faturojë një tarifë mujore të barabartë për të tre Shoqëritë ndërsa për shërbimet e financës dhe kontabilitetit, IT-së tarifa mujore llogaritet bazuar mbi primet e shkruara bruto të muajit përkatës.

13. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Pagat	52,152,334	32,374,630
Kontribute për sigurimet shoqërore	5,474,582	3,618,653
Trainime dhe shpenzime të tjera për personelin	58,889	44,921
Totali	57,685,805	36,038,204

VIG Service Sh.p.k.**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)***14. Shpenzime administrative**

Balanca përbëhet si më poshtë:

	Year ended 31 December 2013	Year ended 31 December 2012
Qera	6,686,985	2,898,000
Shpenzime telefoni dhe poste	1,946,136	1,340,076
Karburant	1,577,500	1,134,380
Mirëmbajtje dhe riparime	2,700,444	861,898
Auditimi financiar	1,660,717	-
Kancelari	678,131	587,975
Shpenzime pritje përcjellje dhe donacione	502,800	537,312
Utilitete (Energji dhe ujë)	670,121	411,353
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	840,558	314,275
Shpenzime pastrami	105,200	85,585
Shpenzime ligjore	66,272	80,847
Taksa locale	106,670	57,223
Shpenzime të tjera	51,611	22,866
Gjoha dhe penalitete	52,519	15,625
Totali	17,645,664	8,347,415

15. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
<i>Të ardhura financiare</i>		
Fitim neto nga kurset e këmbimit	1,639	6,601
Të ardhura nga interesat	-	2,231
Të tjera	-	331
	1,639	9,163
<i>Shpenzime financiare</i>		
Komisione bankare	(48,287)	(36,565)
	(48,287)	(36,565)
Totali	(46,648)	(27,402)

16. Shpenzime për tatim fitimin

Pasqyra më poshtë paraqet një llogaritje të fitimit të tatueshëm dhe ndryshimit në tatim:

	Year ended 31 December 2013	Year ended 31 December 2012
Fitimi para tatimit	3,181,885	2,616,004
Shpenzime të pazbritshme	93,019	1,939,936
Fitim i tatueshëm	3,274,904	4,555,940
Shpenzimi për tatim fitimin (norma: 10%)	(327,490)	(455,594)

VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

17. Palët e lidhura

Palët e lidhura për Shoqërinë përbëhen nga shoqëria mëmë dhe aksionarët e saj. Më poshtë jepen palët e lidhura dhe lloji i lidhjes:

- Interalbani Sha – aksionar
- Intersig Sha – aksionar
- Sigma Sha – aksionar
- Vienna Insurance Group AG – shoqëri mëmë

Gjatë vitit 2013, Shoqëria mëmë ka marrë pjesë në një sërë transaksionesh me palët e lidhura. Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 jepet si më poshtë:

	2013	2012
Të arkëtueshme/(Të pagueshme)		
Detyrime nga Intersig VIG Sh.a	6,276,041	3,155,535
Detyrime nga Sigma VIG Sh.a	2,283,453	2,120,806
Detyrime nga Interalbani VIG Sh.a	2,784,623	367,490
Detyrime ndaj Sigma VIG Sh.a	-	(710,048)

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura, pjesë e të ardhurave jepet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Sigma VIG Sh.a	25,730,181	18,107,660
Interalbani Sh.a	25,676,283	15,142,537
Intersig Sh.a	29,244,078	14,959,438
Totali	80,650,542	48,209,635

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura, pjesë e shpenzimeve jepet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Sigma VIG Sh.a	6,686,985	2,898,000
Intersig VIG Sh.a	-	154,166
Vienna Insurance Group	2,447,440	684,844
Totali	9,134,425	3,737,010

Shumat për tu paguar VIG Sh.a lidhen me marrjen me qira të zyrave. Shumat për tu paguar Vienna Insurance Group AG lidhen me shërbimet e mirëmbajtjes së SAP.

18. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Angazhime qeraje

Shoqëria i paguan qera vjetore SIGMA VIG për përdorimin e zyrave të saj. Angazhimet e qerasë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Jo më vonë se një vit	1,020,398	3,864,000
Total	1,020,398	3,864,000

VIG Service Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

19. Çështje ligjore

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë çështjeve gjyqësore, pretendimi apo padie më datë 31 dhjetor 2013.

20. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.